



Prishtinë: 19.12.2008.

Kodi i ZRRE-së: V_147_2008

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_R_141_12_08

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK_R_141_12_08; dhe
5. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

Në mbledhjen e mbajtur më 19 dhjetor 2008 nxori këtë:

VENDIM

PRANOHET PJESËRISHT ankesa e konsumatorit Luan Kuqi (shifra e konsumatorit DPZ – 9021271) nga Theranda, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK në ZRRE me datë 26.06.2008 ka apeluar përgjigjen e departamentit për konsumatorë në KEK të datës 16.06.2008, lidhur me ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar.

- Me datë 24.08.2007, konsumatori ka bërë kërkesë dhe ka bërë pagesën për ndërrimin e njehsorit elektrik.
Provë: Dëftesë pagesa DPZ0&MC0823116050/18 e datës 24.08.2007.
- Me datë 17.09.2007, ekipi i autorizuar i KEK-ut ka bërë ndërrimin e njehsorit elektrik ku është hequr njehsori nr. 31815 dhe është vendosur njehsori i ri nr. 44056328.
Provë: Procesverbali i KEK-ut mbi ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 0382 të datës 17.09.2007.
- Me datë 12.12.2007, qendra e kalibrimit në KEK ka bërë kontrollimin detal të njehsorit dhe gjatë kontrollimit ka konstatuar se njehsori elektrik vulat (blllombat) shtetërore i ka të manipuluar, qelqi i njehsorit nuk është i vendosur në vend si dhe numëruesi i manipuluar.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 10/12 të datës 12.12.2007.
- Me datë 21.03.2008, ekipi i autorizuar i KEK-ut ka dalë në vendin e ngjarjes tek konsumatori dhe ka regjistruar gjendjen e pikës matëse tek konsumatori dhe kanë marrë profilin e kabllit furnizues si dhe të dhënat tjera teknike.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 0140651 i datës 14.05.2008.
- Me datë 29.03.2008, KEK-u e ka ngarkuar me ngarkese për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPZ08HP04175 në vlerë prej 8,917.56 €.
Provë: Fatura e harxhimit të paautorizuar DPZ08HP04175 e datës 29.03.2008.



- Me date 04.04.2008, konsumatori ka parashtruar ankesë në departamentin për konsumatorë në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK.
- Me datë 16.06.2008, departamenti për konsumatorë në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në procesverbalin e qendrës së kalibrimit.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 17.06.2008.
- Me datë 26.06.2008 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së.
- DMK në ZRRE në bashkëpunim me Departamentin për Konsumatorë në Divizionin e Furnizimit në KEK ka kthyer lëndën e konsumatorit për rishqyrtim.
- Departamenti për Konsumatorë në KEK ka formuar komisionet përkatëse brenda KEK-ut për rishqyrtimin e lëndës së konsumatorit, komisioni përkatës për rishqyrtimin e ankesës ka vendosur të anulojë faturën e rikthimit të humbjeve.

DMK në ZRRE pas analizimit të bërë dëshmime të energjisë të paraqitura nga KEK-u dhe konsumatori, ka vërejtur se:

- Konsumatori sipas deklaratës së tij në lokalin ekzistues e ka vendosur njehsorin i cili ka qenë i vendosur në lokalin e vjetër i cili ka qenë i demoluar gjatë luftës; pa ndonjë verifikim paraprak.
- Konsumatori vetë ka bërë kërkesë për ndërrimin e njehsorit kur ka vërejtur se i njëjti nuk po punon dhe ai po faturohet paushall.
- Sipas analizës së bërë të rrjedhjes së energjisë aktive, shihet se njehsori i konsumatorit është bllokuar në muajin e 3-të të vitit 2007.
Provë: Rrjedhja e energjisë aktive.
- Faktet e paraqitura në procesin e kalibrimit mund të jenë si pasojë e abuzimit të mëhershëm të njehsorit (para lufte), ose abuzimit që ka mund të ndodh në muajin e 2-të 2007 (në këtë muaj njehsori është ndalur së regjistruari). Para muajit të 2-të 2007 nuk mund të vërehet ndonjë devijim i dukshëm i regjistrimit të konsumit në këtë njehsor, gjithnjë duke marrë parasysh pajisjet elektrike që i ka konsumatori në këtë lokal.
- Përgjigja e parë e KEK-ut dhënë konsumatorit është shumë e mangët ngase nuk janë marrë për bazë konsumi mesatar i konsumatorit por vetëm është thirrur në procesverbalin e qendrës së kalibrimit.
Provë: Përgjigja e KEK-ut.
- KEK-u pas rishqyrtimit të lëndës së konsumatorit nga komisioni përkatës ka pranuar pjesërisht ankesën e konsumatorit dhe ka propozuar që ta ngarkojë konsumatorin me faturë për rikthim të humbjeve në vlerë 1131,51 €.
- Në bazë të informatës së marrë nga raporti i rishqyrtimit nga ana e KEK-ut, ekipet e të cilit kanë bërë inspektim të pikës matëse të konsumatorit, vërtetohet se konsumatori posedon në lokalin e tij këto pajisje elektrike: 10 poqa (10 x 25 W) dhe një nxehëse (nuk është shënuar fuqia) por do të supozojmë se ajo është 3 kW

DMK në ZRRE pas analizimit të dëshmime të paraqitura rekomandon Bordit të ZRRE-së që të **pranojë pjesërisht** ankesën e konsumatorit.



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet e paraqitura dhe ka vendosur që ta **pranojë pjesërisht** ankesën e konsumatorit për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së,
Sipas këtij vendimi, KEK-u është i obliguar që:

1. Ta shkarkojë konsumatorin nga fatura e ngarkuar për shfrytëzim të paautorizuar DPZ08HP04175 në shumë prej 8,917.56 €.
2. Ta ngarkojë konsumatorin për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë për periudhën nga muaji i 3-të 2007 deri në muajin e 9-të 2007 (7 muaj), duke marrë parasysh procedurën që ka qenë në fuqi (sipas pajisjeve elektrike dhe kohëzgjatjes së shfrytëzimit) dhe duke ja zbritur kW e ngarkuar gjatë kësaj periudhe.
3. Llogaritja e energjisë së konsumuar në mënyrë të paautorizuar të bëhet sipas procedurës në fuqi në atë kohë "Gazeta Zyrtare e KSAK" Neni 45 dispozita 2 b); sipas kësaj dispozite për llogaritjen e energjisë të merret parasysh ngarkesa maksimale e konsumatorit që është 3,25 kW (në bazë të shënimeve të KEK-ut), sezonet e shfrytëzimit (verore dhe dimërore) dhe duke e zbritur energjinë e faturuar për këta 7 muaj.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente të Prishtinës, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimi të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Dr. Nysret Avdiu, anëtar